



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT BE QENDRA

BE LAJME



Korrik 2019
BEQ– nr. 47/2019

KRYESIMI FINLANDEZ ME BASHKIMIN EVROPIAN

EU2019.FI Finland's Presidency
of the Council
of the European Union

Evropë e qëndrueshme—e ardhme e qëndrueshme

Finlanda kryeson me Këshillin e Bashkimit Evropian nga korriku deri në fund të dhjetorit të këtij viti. Treshja aktuale e vendeve anëtare të BE-së që bëjnë rotacion prej 18 muaj janë Rumania, Finlanda dhe Kroacia. Programi 18-mujor i të tre vendeve përcakton qëllimet afatgjata dhe agjendën e përbashkët për temat dhe çështjet kryesore që duhet të adresohen nga Këshilli i BE-së.

Prioritetet e Presidencës finlandeze, e cila kryeson Këshillin e BE-së për herë të tretë, janë si më poshtë:

1. forcimi i vlerave të përbashkëta dhe sundimi i ligjit;
2. Bashkim Evropian më konkurrues dhe shoqëror gjithëpërfshirës;
3. forcimi i pozitës së BE-së si udhëheqës global në veprimet klimatike;
4. Mbrojtje gjithëpërfshirëse e sigurisë së qytetarëve.

Bashkimi Evropian përballët me një mjedis global më kompleks dhe të paparashikueshëm, konkurrencë të lartë për fuqi dhe sfida ndaj sistemit të rregullave dhe parimeve ndërkombëtare.

Themelet e Bashkimit Evropian - paqja, siguria, stabiliteti, demokracia dhe prosperiteti duhet të mbrohen vetëm duke punuar së bashku dhe duke mbrojtur vlerat e përbashkëta evropiane.

Sundimi i ligjit duhet të forcohet në mënyrë që BE të jetë në gjendje të mbrojë me besueshmëri një sistem multilateral bazuar në rregulla dhe institucione ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe t'u sigurojë qytetarëve evropianë paqe dhe të drejta të barabarta. Transparenca, rregullimi më i mirë, përfshirja e qytetarëve dhe respektimi i parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit janë thelbësore për të rritur besimin te BE-ja.

Politika e zgjerimit është investim strategjik në paqen, stabilitetin dhe zhvillimin e Evropës. Vlerat themelore evropiane janë thelbësore për të gjithë partnerët që aspirojnë anëtarësimin në BE. Finlanda do të vazhdojë të punojë në perspektivën e besueshme të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor, një rajon me vlerë të lartë strategjike për BE-në. Finlanda mori presidencën e BE-së në një moment të rëndësishëm kur liderët e BE-së arritën marrëveshje mbi një agjendë ambicioze strategjike të BE-së për 2019-2024 në takimin e Këshillit Evropian në fund të qershorit. Presidenca finlandeze do të jetë e para që do të përfshijë prioritetet e reja nga agjenda strategjike e BE-së në punën e Këshillit.

Përmbajtja e lajmeve:

Kryesimi Finlandez me Bashkimin Evropian	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2-3
Samiti i Ballkanit Perëndimor në Poznan	3
Aktivitetet e Kuvendit lidhur me çështjet evropiane	4-5
Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Greqi	6
Sa nëpunës evropianë e njohin kornizën etike të BE-së	6
Harmonizimi i legjisllacionit polak në fushën e jurisprudencës	7
Ndërprerja e pasigurt e shitjes së automjeteve me derivate fosile në Danimarkë	7
Franca miraton ligj të ri për luftën kundër gjuhës së urrejtjes	8
Investimet e drejtpërdrejta të huaja në BE në vitin 2018	8
Boris Xhonsen lider i ri i konservatorëve britanikë	9
Samiti i Procesit për bashkëpunim në Evropën Juglindore	9
Ndikimi i medieve sociale mbi të rinjtë	10
Luksemburgu me shkallë më të lartë të automjeteve për kokë banori në BE	10
Mbështetja financiare për çiftet bashkëshortore në Hungari	11
Publikimi i ri dixhital i Eurostatit	11
BE kalendar / shtator 2019	11

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN


www.europarl.europa.eu

**U konstitua përbërja e
nëntë e Parlamentit
Evropian.**

**David Sasoli me 345
vota u zgjosh kryetar i
Parlamentit Evropian.**

**Ursula Fon Der Lajen
u zgjodh kryetare e
Komisionit Evropian.**

Seanca plenare 02-04 korrik 2019

Përbërja e nëntë e Parlamentit Evropian u konstitua më 2 korrik 2019 në Strasburg. Përbërja e re e Parlamentit Evropian ka 61% eurodeputetë të rinj krahasuar me përbërjen e mëparshme dhe një numër më të madh të grave deputete 40%, krahasuar me 37% në përbërjen e vitit 2014.

Deputet më i ri është Kira Mari Peter Hansen nga Danimarka, 21 vjeç, më i vjetri është Silvio Berlusconi i Italisë (82). Parlamenti i ri përbëhet nga shtatë grupe politike - një më pak se përbërja e mëparshme, ndërsa të gjithë deputetët që nuk janë anëtarësuar në një grup të veçantë janë të pavarur. Sipas Rregullores së Punës të Parlamentit Evropian nga viti 2009, një grup politik është i përbërë nga të paktën 25 deputetë të zgjedhur në të paktën shtatë vende anëtare të BE-së.

Eurodeputetët votuan dhe e konfirmuan përbërjen dhe numrin e anëtarëve të 20 komiteve parlamentare dhe dy nënkomiteve. Kryesuesit do të zgjidhen në mbledhjen konstituive të secilit komitet dhe nënkomitet. Grupet politike duhet t'i raportojnë listat e zëvendësve të tyre në komisione.

Katër kandidatë për funksionin Kryetar të Parlamentit Evropian, Ska Keler, Sira Rexho, David-Maria Sasoli dhe Jan Zahradil, e prezantuan vizionin e tyre për udhëheqjen e tyre me PE-në, me fjalime të ndara. Pasi miratoi 345 nga gjithsej 667 vota të vlefshme në rrethin e dytë, David Sasoli u zgjodh Kryetar i Parlamentit Evropian, i cili do ta drejtojë Parlamentin deri në janar 2022. Si eurodeputet i Italisë nga viti 2009, Sasoli u rizgjodh në listën e Partito Demokrati në qendër të Italisë në maj 2019 për një mandat të tretë.

Kandidat për Kryetar të PE-së mund të propozohet nga një grup politik ose 1/20 të eurodeputetëve, përkatësisht 38 eurodeputetë që përfaqësojnë një "prag të ulët" të prezantuar nga Rregullorja e Rishikuar e Punës së PE-së. Zgjedhja e Kryetarit bëhet me votim të fshehtë (neni 15 i Rregullores), dhe për t'u zgjedhur

kandidati duhet të fitojë një shumicë absolute të votave të vlefshme, përkatësisht 50% plus një.

Në seancën plenare, 14 nënkryetarët e Parlamentit Evropian me votim në tri rrethe, me mandat dy vjet e gjashtë muaj.

Në debat, eurodeputetët vunë në dukje mungesën e përfaqësimit të vendeve të Evropës Lindore, si dhe rolin e tepëruar në gjithë procesin nga ana e liderëve të vendeve anëtare në mosrespektimin e sundimit të së drejtës. Shumica e eurodeputetëve ishin kritikë për mënyrën se si zgjidhen kandidatët për pozicionet më të larta të BE-së, pavarësisht nga procedura e përzgjedhjes së kandidatëve. Me mandat dy vjet e gjysmë nga aklamacioni, u zgjodhën pesë kuestorë të rinj të PE-së që merren me çështjet administrative. Së bashku me kryetarin dhe nënkryetarët, kuestorët e formojnë Byronë e Parlamentit Evropian në të cilën janë përcaktuar rregullat për funksionimin e Parlamentit. Ndër detyrat e tjera, Byroja e përgatit propozim-buxhetin e Parlamentit dhe vendos për çështjet administrative dhe të kuadrit.

Sesioni plenar 15-18 korrik 2019

Përpara zgjedhjes së kryetarit të Komisionit Evropian në seancën e dytë plenare të PE-së në korrik, Ursula Fon Der Lajen e prezantoi vizionin e vet për BE-në të përkushtuar në luftimin kundër ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e vlerave evropiane dhe demokracisë dhe të jetë vendimtar në luftën për barazinë gjinore. Në fjalimin, Fon Der Lajne propozoi një qëllim edhe më të guximshëm për të zvogëluar emetimet e gazrave të dëmshme për 55% deri në vitin 2030, në vend të 50% aktual.

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Gjatë 100 ditëve të para në krye të Komisionit Evropian, Lajen u zotua të dërgojë plan për "Marrëveshjen e Gjelbër për Evropën" dhe ligjin evropian për klimën. Gjithashtu i publikoi planet për investime të qëndrueshme evropiane, duke e përfshirë shndërrimin e pjesshëm të fondeve të Bankës Evropiane të Investimeve në "bankën klimatike", për të siguruar një investim me vlerë 1 trilion euro gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

Eurodeputetët kanë debatuar për rezultatet e realizuara nga Kryesimi i Rumanisë me BE-në, pas fjalimeve të kryeministrit Viorika Dançilla dhe nënkryetarit të Komisionit, Marosh Shefçoviq.

Parlamenti Evropian e aprovoi përbërjen e 44 delegacioneve ndërparlamentare për bashkëpunimin parlamentar me shtetet, rajonet dhe organizatat e tjera, duke

përfshirë edhe një Delegacion për Marrëdhënie me Republikën e Maqedonisë së Veriut prej 13 anëtarësh dhe zëvendësit e tyre.

Miratimi i përbërjes së delegacionit në sesionin plenar të Parlamentit Evropian bëhet në bazë të vendimeve të brendshme të grupeve politike dhe anëtarëve të pavarur të PE-së.

Në përbërjen e Delegacionit duhet të sigurohet përfaqësimi i drejtë i vendeve anëtare, mendimeve politike dhe përkatësive gjinore.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i delegacionit do të zgjidhen në mbledhjen themeluese të delegacionit, që duhet të mbahet në shtator të këtij viti.



www.europarl.europa.eu

U miratua përbërja e Delegacionit të PE-së për Marrëdhënie me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SAMITI PËR BALLKANIN PERËNDIMOR NË POZNAN

Samiti i Ballkanit Perëndimor u mbajt më 4-5 korrik në Poznan, ku BE-ja e konfirmoi angazhimin për të forcuar bashkëpunimin me rajonin përmes masave konkrete të përqendruara në pesë fushat kryesore: transportin dhe energjinë, ekonominë dixhitale, sigurinë dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore.

Liderët pjesëmarrës në Samit njëllozi e konfirmuan perspektivën evropiane të rajonit, sipas dokumentit të qeverisë polake nga konkluzionet e Samitit në Poznan.

Propozimi për të organizuar dialogun parlamentar midis vendeve të Ballkanit Perëndimor të disa vendeve u mbështet nga pjesëmarrësit e Samitit, thuhet në raportin "Evropë - Ballkani Perëndimor".

Në Samit u theksua mbështetja për përparësitë e Ballkanit Perëndimor (Agjendën e Lidhjes), zona ekonomike rajonale, si dhe përforsimi i sundimit të së drejtës dhe të drejtave themelore në rajon.

Si detyrë me përparësi të lartë për zgjidhjen e problemeve bilaterale u theksuan rastet e personave të zhdukur dhe krimeve të luftës. Dokumenti gjithashtu ka të bëjë me të ardhmen e Procesit të Berlinit dhe samitin tjetër që do të mbahet në vitin 2020 kur organizatorë do të jenë Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut.

Në samitin në Poznan, për Republikën e Maqedonisë së Veriut u lejua mjetet për projekte në vlerë prej 43 milion euro.



Samiti u mbajt në Poznan sepse me Procesin e Berlinit në këtë moment kryeson Polonia që si prioritet të kryesimit i thekson bashkëpunimin ekonomik, kulturor dhe sigurinë, shoqërinë civile dhe të rinjë, zhvillimin e energjetikës dhe infrastrukturës së transportit.

Në kuadër të Procesit të Berlinit deri më tani janë mbajtur pesë samite: në Berlin (2014), Vjenë (2015), Paris (2016), Trieste (2017) dhe Londër (2018).

U lejua mjetet për projektet prej 43 milionë euro për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

<http://europa.eu/>

AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk

Delegacioni i Kuvendit i udhëhequr nga Kryetari Talat Xhaferi, bashkë me nënkryetaren Frosina Tashevska Remenski dhe koordinatori i grupit parlamentar të VMRO-DPMNE-së Nikolla Micevski, nga 17 deri 19 korrik 2019 morën pjesë në Forumin për partneritet demokratik të Dhomës së përfaqësuesve të SHBA-së. Në kuadër të forumit u takuan me Poll Fufer, përfaqësues i lartë i zyrës për Evropën Jugore dhe Qendrore në Stejt Departamentin. Në takimin Fufer i përshëndeti nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes për Fqinjësi të Mirë me Bullgarinë. Delegacioni gjatë vizitës realizoi takim edhe me përfaqësuesin e lartë të Komitetit për Punë të Jashtme të SHBA-së, Damjan Marfi. Në forumin kryetari Xhaferi mbajti fjalim me temë "Transparenca legislative dhe transparenca për rritje të besimit dhe përfshirjes së qytetarëve".

Drejtori i NDI-së, Derek Miçell organizoi takim të përbashkët të përfaqësuesve të parlamenteve të të gjitha vendeve pjesëmarrëse në forumin. Në prezantimin Kryetari Xhaferi e theksoi qëllimin që Kuvendi të jetë institucion i pavarur në aspekt të administratës, sigurimit dhe financave me kapacitet më të fortë në kryerjen e rolit të vet mbikëqyrës mbi pushtetin ekzekutiv.

Kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi më 07 korrik 2019 u takua me Eliot Engell, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme të Dhomës së përfaqësuesve të Kongresit të SHBA-së. Engell e riafirmoi mbështetjen e fuqishme të SHBA-së për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO, njëkohësisht duke uruar për përcaktimin e shtetit tonë për zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe guximin e treguar gjatë miratimit të vendimeve të vërteta në drejtim të zgjidhjes së të gjitha çështjeve të hapura. Të dy bashkëbiseduesit theksuan se marrëdhëniet bilaterale ndërmjet të dyja shteteve janë në nivel më të lartë nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike dhe vazhdimisht e ndjekin trendin rritës.



Kryetari i Kuvendit Talat Xhaferi më 26 korrik u takua me Filip T.Riker, u.sh. ndihmës sekretar shtetëror i SHBA-së për çështje evropiane dhe euroaziatike, ndërsa ishte e pranishme edhe ambasadorja e SHBA-së, SH.T. Kejt Mari Bërnz. Në takimin u këmbyen mendime për aktivitetet aktuale në pjesën e integriteteve euroatlantike dhe anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO dhe në BE, si dhe për bashkëpunimin bilateral ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së. Të dy bashkëbiseduesit shprehën pritje se vendi deri në fund të vitit do të bëhet anëtarja e 30-të e NATO-s dhe u dakorduan se marrëdhëniet e mira strategjike dhe të afërta ndërmjet të dyja vendeve do të vazhdojnë të kultivohen dhe avancohen edhe në të ardhmen.

Më 02 korrik 2019 kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi u takua me Antonio Misioli, zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s për sfida të reja të sigurisë, i cili qëndroi në vizitë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në takimin bashkëbiseduesit këmbyen mendime për rëndësinë dhe rolin e demokracisë parlamentare, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përfshirjen e Kuvendit në evenimentet dhe forumet ndërkombëtare, si dhe menaxhimin e balancës ndërkombëtare ndërmjet forcave politike në vend në drejtim të ndërtimit të parlamentit funksional.



AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Në kuadër të Kryesimit të Finlandës me Bashkimin Evropian, Shpresa Hadri, anëtare e Komisionit për Çështje Evropiane të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 21 dhe 22 korrik 2019 mori pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare për Çështje Evropiane të Vendeve Anëtare të BE - KOSAK, që u mbajt në Helsinki, Finlandë. Në fjalimin në konferencë, Hadri theksoi se anëtarësimi në BE është një motiv i fortë dhe nxitës i reformave evropiane në të gjitha fushat në rajon.



Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të udhëhequr nga Fadil Zendeli, kryetar i Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit dhe Deputetëve Sashko Atanasov, Trajço Dimkov, Panço Minov, Sllagjana Mitovska, si dhe Zeqir Ramçilloviq, kryetar i Grupit parlamentar i Kuvendit për bashkëpunim me Parlamentin e Bosnjë e Hercegovinës, më 09 korrik 2019 u takua me Duda Balen, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione të Republikës së Kosovës. Në takimin bashkëbiseduesit theksuan se të dyja vendet punojnë në respektimin e të drejtave të njeriut dhe shprehën gatishmëri për të vazhduar me realizimin e kontakteve të rregullta.

Më 10 korrik 2019 kryetari Xhaferi mbajti fjalim në evenimentin promovues me rastin e nënshkrimit të memorandumit për mirëkuptim për vendosjen e bazës ligjore për realizimin e projektit "Programi për mbështetje të Parlamentit" me Zvicrën. Në evenimentin ishte i pranishëm edhe ambasadori i Konfederatës zvicerane në Republikën e Maqedonisë, Sibil Zuter Tehada. Implementues i projektit u zgjodh Instituti demokratik nacional.



www.sobranie.mk

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në AP të OSBE-së të udhëhequr nga deputeti Vlladimir Gjoçev, shëf i Delegacionit dhe anëtarët Jagoda Shahpaska dhe Rexhail Ismaili nga 04 deri 08 korrik 2019 morën pjesë në Sesionin e 28-të vjetor të Asamblesë parlamentare të OSBE-së. Të tre komisionet e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së diskutuan për raportet dhe propozim-rezolutat me temë: "Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm për promovimin e sigurisë: roli i parlamenteve". Në sesionin vjetor u miratua "Deklarata e Luksemburgut" në të cilën janë përfshirë një spektër i gjerë i rekomandimeve për çështje nga fusha e politikës, ekonomisë, mjedisit jetësor dhe të drejtave të njeriut, që janë dorëzuar nga qeveritë e vendeve pjesëmarrëse. Sesioni vjetor është mbledhja më e madhe e Asamblesë parlamentare e OSBE-së, të cilin e përbëjnë 323 parlamentarë nga 57 vende nga Evropa, Azia Qendrore dhe Amerika Veriore.

Ligjet e IPAA të miratuara në Kuvend në qershor 2019

	Titulli i ligjit	Kapitulli	Seanca plenare
1	Ligji për kontroll të qarkullimit të jashtëm tregtar me diamante të papërpunuara	30 MARRËDHËNIE TË JASHTME	Seanca nr. 104, 9.07.2019

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT TË POLONISË NË FUSHËN E JURISPRUDENCËS

Komisioni Evropian më 17 korrik të këtij viti raportoi se po kalonte në fazën e dytë të procedurës për shkeljen e rregullave evropiane në Poloni dhe paraqiti mendim me arsyetim për regjimin e ri disiplinor për gjyqtarët polakë. Komisioni caktoi afat dymujor për Poloninë për të harmonizuar sistemin e procedurave disiplinore dhe dënimit për gjyqtarët me qëllim të garantojë pavarësinë e gjyqtarëve dhe mbrojtjen e tyre nga kontrolli politik.

Nëse Polonia nuk ka ndërmarrë masa adekuate, Komisioni mund të vendosë që çështjen ta drejtojë deri te Gjykata e Drejtësisë të BE-së.

Legjislacioni polak lejon gjyqtarët e gjykatave themelore që t'i nënshtrohen hetimeve disiplinore, procedurave dhe sanksioneve bazuar në përmbajtjen e vendimeve të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën sipas nenit 267 të Marrëveshjes për Funkcionim të BE për të kërkuar vendime preliminare nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Në muajt e fundit, Polonia ka filluar procedura disiplinore kundër gjyqtarëve të cilët kanë filluar dërgimin e pyetjeve në Gjykatën e Drejtësisë të BE-së për pavarësinë e gjyqësorit në Poloni pas reformës. Ky ishte konfirmim i mjaftueshëm për Komisionin Evropian që gjyqtarët po ndëshkohen për vendimet e tyre.

Procedura për përcaktimin e thyerjes të legjislacionit evropian



në gjyqësorin me procedura disiplinore kundër gjykatësve, Komisioni Evropian e filloi më 3 prill

2019. Komisioni Evropian publikoi se do t'i përdorë paditë në mënyrë të rregullit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe do të kërkojë Gjykatës së BE të vendos masa të përkohshme me qëllim të paragrafëve të kontestuar të zgjidhen me gjykime përfundimtare. Në këtë mënyrë, Gjykata e BE ka arritur paraprakisht të vërë fund të pastrimeve në Gjykatën Supreme të Polonisë.

Sundimi i të drejtë është me rëndësi thelbësor për funksionimin e BE-së dhe duhet të respektohet nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, theksoi Presidentja e re

NDËRPRERJA E PASIGURTË NË SHITJEN E AUTOMJETEVE TË DERIVATEVE FOSILE NË DANIMARKË

Në letrën e Komisionares të BE për Tregun e Brendshëm dhe Industrisë, Elzbieta Bienkowska drejtuar deri te Komitetit Evropian të Parlamentit Danez (Europaudvalg), deklaroi se ndalimi i shitjes së automjetit të benzinës ose çizelit është në kundërshtim me ligjet e BE-së. Ndalea për shitje, import ose regjistrimit të automjeteve të benzinës ose dizel nga ana e disa vendeve anëtare do të paraqet shkelje të rregullave të miratuara në nivel të BE.

Nëse Danimarka dëshiron të zbatojë ndalimi është e nevojshme të ndryshohen rregullat e BE, që është pak e besueshme që të arrihet deri 2030. Nga ana tjetër, interesimi i Gjermanisë për prodhimin e automobilave dhe legjislacioni që e rregullon të njëjtën është arsyeja kryesore për situatën e ndodhur.

“ Është më shumë se e qartë se automobilat elektrik janë fenomen tejkuftar. Automjetet voziten përmes kufijve nacionale, prodhohen dhe shiten në të gjithë Evropën, kështu që kjo zonë duhet të rregullohet në nivelin e BE-së ”, theksoi profesor i shkencave politike në Universitetin e Kopenhagës Peter Nedergard.

Arsyeja kryesore për mosharmonizimin është interesi i



Gjermanisë në industrinë e automobilave dhe ligjet që vlejnë për prodhuesit e automobilave. Në mënyrë plotësuese shtrohet çështja e rregullimit të automjeteve elektrike, ku Gjermania si një prodhues kryesor i makinave ka interes të madh.

Qeveria aktuale Daneze, si dhe ajo e mëparshme vendosi për qëllim deri në vitin 2030 të ndalojë shitjen e makinave me karburant fosil. Por, arritjen e qëllimit mund ta Bllokojë Bashkimi Evropian.

www.thelocal.dk

FRANCA VENDOS LIGJ TË RI PËR LUFTËN KUNDËR GJUHËS SË UREJTJES



Deputetët francezë më 10 korrik 2019 miratoi një Ligj për luftë kundër gjuhës së urrejtjes.

Ligji i ri detyron rrjetet e mediave sociale që të heqin përmbajtjen ofenduese brenda 24 orëve dhe të krijojnë buton të ri për t'i lejuar përdoruesit ta shënojnë keqpërdorimin.

Anëtarët e dhomës së poshtme të parlamentit miratuan ligjin me 434 vota, 33 kundër dhe 69 abstenime.

Ligji u krijua nën legjislacionin gjerman që hyri në fuqi vitin e kaluar.

Uebfaqet që nuk respektojnë dispozitat e ligjit të ri dhe nuk heqin përmbajtjen "padyshim fyese" do të përballen me një gjobë prej 1.4 milion dollarësh.

Kërkimet e internetit si Google gjithashtu do të duhet të fshijnë përmbajtje të tillë brenda 24 orësh.

Senati i dhomës së sipërme do të marrë në konsideratë legjislacionin pas pushimeve verore me mundësinë e propozimit të ndryshimeve.

Kritikët thonë se ligji lë shumë fuqi në duart e platformave në internet, duke i bërë arbitra të fjalës në fjalim online dhe mund t'i nxisin ata të tërheqin përmbajtjen në rast dyshimi, në vend që të rrezikojnë gjobë në para.

Facebook gjithashtu dyshon nëse periudha e heqjes 24-orëshe është realiste, duke thënë se shumë opinione kërkojnë analizë të kujdesshme dhe vlerësim të saktë ligjor.

Gjigantët teknikë, përfshirë Facebook dhe YouTube, kanë njoftuar masa anti-urrejtje dhe përmbajtje të dhunshme muajt e fundit.

<https://www.euractiv.com>

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË BE-në NË VITIN 2018

Kanada dhe në masë më të vogël Zvicra në vitin 2018 ishin investitorët kryesorë direktë në BE-në. Kompanitë e BE-së kanë investuar më shumë se 90 miliardë euro në Kanada dhe kanë krijuar gati 57 miliardë euro detyrime neto ndaj investitorëve të tyre kanadezë.

Zvicra tregon rregullsi në marrëdhëniet e investimeve të huaja direkte (IHD) me BE. Vlerësimet në vitin 2018 tregojnë nivele më të ulëta të eksportit dhe importit të kapitalit (IHD) me tregun zviceran (përkatësisht 63 miliardë dhe 27 miliardë euro), në krahasim me vitin 2017. Dalja dhe fluksi i investimeve të huaja direkte të BE-së në Zvicër mbeti i dukshëm edhe në vitin 2018, me Zvicrën në krye të listës së lojtarëve më të mirë të IHD në tregun e BE-së.

Rezultatet e vitit 2018 tregojnë për përjashtimin e përgjithshëm të kapitalit të investimeve të drejtpërdrejta që qarkullojnë ndërmjet BE-së dhe pjesës tjetër të botës. Dalja neto e IHD ishte negative - 60 miliardë euro, që është diametralisht e kundërt me shumën e investuar në vitin 2017, 301 miliardë euro. Kjo është për shkak të rënies së përgjithshme të eksporteve të kapitalit të IHD-ve në tregun amerikan. Sipas vlerësimeve, ndërmarrjet amerikane tërhoqën gati 177 miliardë euro kapital neto të IHD nga tregu i BE-së. Si rezultat, investitorët e BE tërhoqën 165 miliardë dollarë investime neto nga tregu amerikan.

Megjithë listën e kufizuar të partnerëve, shumat e investuara në BE nga partnerët e tjerë të IHD (dhe



anasjelltas) ishin të kufizuara, dhe asniher duke mos kaluar prag prej 10 miliardë eurosh nga secila anë.

Të dhënat e detajuara dhe të rishikuara vjetore të IHD për vitin 2018 do të publikohen nga Eurostat në dhjetor 2019.

<https://ec.europa.eu>

BORIS XHONSON LIDERI I RI I KONSERVATIVAVE BRITANIKE

Boris Xhonson është kryeministri i ri i Britanisë së Madhe dhe lider i Konservatorëve. Në zgjedhjet plotësuese, pas dorëheqjes së Tereza Mej, Xhonson fitoi 92,153 vota, krahasuar me kundërshtarin e tij, Xheremi Hunt, me 46,656 vota nga anëtarët e partisë.

Ai vjen në vend Tereza Mej, e cila dha dorëheqjen pasi plani i saj i filladit u refuzua vazhdimisht në Parlamentin Britanik.

Sfida kryesore për Xhonson do të jetë pyetja se si të arrihet Bregziti. Në fushatë, ai nuk përjashtoi mundësinë e largimit të BE-së pa marrëveshje, e cila është takuar me kundërshtim të ashpër si nga Partia e Punës e opozitës, ashtu edhe nga disa nga Partia e tij Konservatore. Ish-kryeministria Tereza Mej, i cili planifikon të qëndrojë në parlament, ka thënë se ajo do t'i japë Xhonson "mbështetje të plotë për zyrën e prapme", dhe bashkëpunim konstruktiv pritet gjithashtu nga kryenegociatori i BE për Bregziit, Mishel Barnie.

Disa anëtarë të qeverisë së Mej kanë njoftuar tashmë se ata do të japin dorëheqjen para se Xhonson të marrë postin e ri dhe të pushojë nga puna për shkak të kundërshtimit të tij ndaj qëllimit të Britanisë së Madhe për të lënë Bashkimin Evropian pa marrëveshje. Ministri i Evropës dhe Amerikës Alan Dunkan dhe Ministria e arsimit En Milton tashmë kanë dhënë dorëheqjen, me Ministrin e Financave Filip Hamond dhe Ministrin e jurisprodcencë Dejvid Gok gjithashtu duke dhënë dorëheqjen.

Kryeministri i ri britanik Boris Xhonson u transferua në Douning Strit 10 më 29 korrik me të dashurën e tij Keri Simonds. Me këtë, Xhonson u bë kryeministri i parë britanik në histori që jetoi me partner të pamartuar në rezidencën e kryeministrit. Simmonds u bë drejtori më i ri i komunikimeve në historinë konservatore për 29 vjet, dhe analistët thonë se roli i saj ishte thelbësor në "sjelljen e pamjes së çrregullt të Xhonson gjatë fushatës".

www.theguardian.com



SAMITI I PROCESIT PËR BASHKPUNIM NË EUROPËN JUGLINDORE

Samiti i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore i mbajtur në Jahorina më 9 korrik miratoi Deklaratë duke theksuar se integrimi i plotë i rajonit në BE shërben interesat më të mirë të Evropës dhe se siguria e EJT është parakusht kryesor për sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë kontinentin.

Vendi i veçantë në Deklaratë i kushtohet forcimit të sigurisë në rajon dhe angazhimit të vendeve që marrin pjesë në AP në EJT për të punuar së bashku për të adresuar në mënyrë efektive të gjitha kërcënimet e sigurisë në rajon.

Deklarata konsideron se forcimi i bashkëpunimit ekonomik midis anëtarëve të AP në EJT, si dhe ekonomitë e vendeve të rajonit dhe BE-së, është me rëndësi të madhe për rritjen ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin për qytetarët e Evropës Juglindore. Perspektiva e anëtarësimit në BE ka dëshmuar të jetë nxitja më e fuqishme për reformat e nevojshme, si dhe garantuesi më i mirë i paqes, stabilitetit dhe sigurisë së qëndrueshme në rajon.



Dokumenti thekson nevojën për të ruajtur vrullin e zgjerimit dhe angazhimit të vazhdueshëm për reformën, si dhe besueshmërinë e politikës së zgjerimit, bazuar në kushte të repta dhe të drejta, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe parimi i vlerës së vetvetes.

www.xinhuanet.com

NDIKIMI I MEDIEVE SOCIALE MBI TË RINJËT



Të rinjtë në vendet nordike janë përdoruesit kryesorë të mediave sociale.

Debatet janë përqendruar kryesisht në shpenzimin e tepërt të kohës në mediat sociale dhe rrezikun e shqetësimit psikologjik.

Raporti i ri nga Instituti i Kërkimeve të Lumturisë në emër të Këshillit të Ministrave Nordik, përfshin një kuptim të gjerë të ndikimeve negative të mediave sociale tek të rinjtë.

Raporti analizon nëse ekziston një lidhje midis shëndetit mendor të të rinjve dhe përdorimit të mediave sociale. Një grup studiuesish nordikë besojnë se të rinjtë që po përparojnë në jetë, po përparojnë edhe në mediat sociale, kështu që ka nevojë për fakte më relevante për të vlerësuar situatën.

"Në vend që të fajësojmë të rinjtë për mediat sociale, ne duhet të përqendrohemi në problemet e të rinjve lidhur me vetminë dhe mungesën e mbështetjes së prindërve - thekson në raportin Majkëll Birker, analist i lartë në Institutin e Kërkimit të Lumturisë.

Përfundimi kryesor i raportit është se vetëm mediat sociale nuk janë faktor vendimtar për mirëqenien e të rinjve.

Ky përfundim bazohet në faktin se përdorimi i mediave sociale të të rinjve e pasqyron jetën e tyre shoqërore dhe mirëqenien. Kur bëhet fjalë për të rinjtë, jeta e tyre sociale dhe jeta e tyre në media sociale nuk mund të ndahen.

www.norden.org


LUKSEMBURGU ME SHKALLËN MË TË LARTË TË AUTOMJETEVE PËR KOKË BANORI NË BE

Sipas një studimi të bërë nga Zyra Evropiane e Statistikave - Eurostat në 2017, Luksemburgu me 670 automjete pasagjerësh për 1000 banorë kryesoi në Listën e Automjeteve të BE për kokë banori. Pastaj vijoi Italia me 625 automjete për 1000 banorë, Finlanda (617 automjete), Malta (613 automjete) dhe Qipro (609 automjete).

Numri më i madh i automjeteve të pasagjerëve të regjistruar në të njëjtin vit është regjistruar në Gjermani me 46 milion automjete të regjistruara. Gjatë periudhës pesë vjeçare nga 2013 deri në 2017, ka pasur një rritje të madhe të numrit të automjeteve të regjistruara të pasagjerëve në disa shtete anëtare. Rritja më e lartë në këtë periudhë është regjistruar në Sllovaki (18%), e ndjekur nga Republika e Çekisë dhe Portugalisë (dhe 17%), Estonia (15%), Malta dhe Hungaria (dhe 14%).

<https://ec.europa.eu>

EU Member States with the highest and lowest number of passenger cars per thousand inhabitants, 2017



*Italy: 2016 data; Romania: 2015 data.

eurostat

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR ÇIFTET MARTESORE NË HUNGARI



Si shumë vende të tjera anëtare të BE-së, Hungaria vuan nga mungesa e punës, punëtorët largohen nga vendi në kërkim të pagave më të larta. Kryeministri i Hungarisë Viktor Orban dhe partia e tij e djathtë Fides duan të inkurajojnë rritjen e popullsisë përmes familjeve në përgjigje të imigracionit masiv. Ndërsa niveli mesatar i lindshmërisë në BE është 1.59, Hungaria mbetet në 1.49 fëmijë për grua, sipas Eurostat. Autoritetet hungareze kanë propozuar një hua pa interes prej 10 milion forin (30.950 euro) për çifte familjare. Huaja është pjesë e Planit të Veprimit për mbrojtjen e familjes së Orban, një politikë prej shtatë pikësh, e publikuar gjatë fjalimit, që kushton 4.8% të BPV-së në

programet e mbështetjes së familjes dhe inkurajimin e lindjes. Çiftet duhet të plotësojnë kritere specifike: ata duhet të jenë të martuar; që njëra prej dy bashkëshortëve ta ketë martesën e parë, bashkëshortja duhet të jetë midis moshës 18 dhe 40 vjeç, dhe një nga bashkëshortët të ketë paguar kontribute sociale të paktën 180 ditë në Hungari. Sipas skemës së re, janë paraparë subvencione për veturë për familje të mëdha dhe përjashtime nga tatimi mbi të ardhurat për gratë që kanë rritur të paktën katër fëmijë. Sipas të dhënave të shërbimeve shtetërore, që nga fillimi i korrikut 2,400 familje kishin kërkuar hua të tillë, dhe 14,000 familje kishin kërkuar të paktën një element të planit.

<https://hungarytoday.hu>

PUBLIKI I RI DIGJITAL I EUROSTATIT

Rreth gjysmë miliardë njerëz që jetojnë sot në BE 8% e tyre nuk kanë kombësi nga vendi në të cilin jetojnë. Rreth 1.3 milion evropianë jetojnë në një vend, por punojnë në një vend tjetër të BE-së, rreth 1.7 milion studentë të BE-së studiojnë jashtë vendit. Më 9 korrik, Eurostat publikoi botimin e ri digjital "Njerëzit në lëvizje - Statistikat për lëvizshmërinë në Evropë". Sot, njerëzit në Evropë janë në lëvizje shumë më tepër se kurrë më parë. Kjo lëvizshmëri mund të shihet në shumë mënyra, pasi ka shumë arsye për të lëvizur: migracionin, arsimin, punën ose turizmin.

<https://ec.europa.eu>



BE KALENDAR / shtator 2019

1. Forumi energjetik civil, 12-13/09/2019, Dublin, Irlanda;
2. Sesioni plenar i Parlamentit Evropian, 16-19/09/2019, Strazburg;
3. Java Evropiane e mobilitetit 2019, 16-22/09/2019, nëpër Evropë;
4. Java Evropiane e sportit 2019, 23-30/09/2019, nëpër Evropë;
5. Samiti global për shkencë rregullatore 2019 - nanoteknologji dhe nanoplastikë, 24-26/09/2019, liqeni Maggiore, Itali;
6. Samiti i dytë evropian për arsim, 26/09/2019, sheshi, Bruksel.

European Union Newsroom

europa.eu

EUROPA Newsroom Calendar

Home Highlights Press releases Calendar Audiovisual Press contacts Press facilities Subscription services About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

September

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

Linqe të dobishme për publikime elektronike të BE-së

<https://publications.europa.eu/en/home>

<https://europa.eu/european-union/documents-publications>

<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Октомври пр. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvend ishte zbatuar Projekti IPA Projekt për "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën nga janari 2011 - qershor 2012, qëllimi i të cilit ishte përfundimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve.

Në korniza të projektit IPA, ishte siguruar ndihma financiare dhe ndihma profesionale në vendosjen e qendrës së BE-së në Kuvend.

Qëllimi i formimit të Qendrës së BE-së është deputetëve të Kuvendit dhe Shërbimit tu sigurojë qasje më të mirë në informata lidhur me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është e organizuar në kuadër të Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Nacional të Euro Integrimeve.

Qendra e BE-së disponon me bibliotekë të librave dhe publikimeve nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.

